



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Duke u mbështetur në nenin 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, nenit 47 të Statutit të Komunës dhe nenit 4 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, bën këtë:

N J O F T I M

Njoftohen të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës, që të marrin pjesë në seancën e III-të të punës për vitin 2015, që do të mbahet më 27.03.2015, në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës, duke filluar me punë në orën 10:00.

Kërkohet nga anëtarët e Kuvendit që të marrin pjesë në seancë, ndërsa në rast të mungesës eventuale - mungesa duhet të arsyetohet me shkrim para mbajtjes së mbledhjes.

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së.

Lidhur me këtë seancë propozohet ky:

R E N D I I D I T Ë S

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës së Ekzekutivit përfshirë edhe Raportin e punës së Prokurimit për vitin 2014,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozimit për Ndryshim të Vendimit në Komisionin për vlerësim të ofertave për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës së Klinës, me kandidatin nga radhët e AAK-LDD (në vend të ish- anëtarit Agron Bacaj),
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-planit Lokal të Veprimit Rinor,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për ndarje të Çmimit tradicional të artit "E Bukura Pamore",
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për formimin e Komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale,
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozimit të Kryetarit për dhenje në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale si rast i veçantë (pa procedurë të rregullt të konkurrimit) me propozimin e Kryetarit sipas dy kërkesave të bashkësive fetare:
 - a. Bashkësia Islame e Kosovës – Këshilli i Bashkësisë Islame Klinë (BIK-KBI) Klinë, për ndërtim të Xhamisë në fshatin Kpuz dhe
 - b. Zyra Famullitare Klinë " Zoja e Keshillit të Mirë" për ndërtim të Kishës në fshatin Deiq
9. Sqarimi i Informatës rreth kompensimit të Komiteteve të Kuvendit 2 komitetet obligative dhe 5 komiteteve të tjera (nga Drejtori për FEZH),
10. Të ndryshme.

01Nr. 062102/2015
Klinë, më 1803 2015



KRYESUESI,
Dr. Haxhi Ibishi